



Në bazë të nenit 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010), nenin 4, paragrafi 3 dhe nenin 41, paragrafi 6 të Ligjit nr.05/L-045 për sigurimet (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.38/24 dhjetor 2015), Bordi i Bankës Qendrore i Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 25 shkurt 2016 miratoi:

## **RREGULLORE PËR BASHKIMET DHE PËRVETËSIMET**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë procedurat, të cilat siguresit janë të obliguar t'i kryejnë në procesin e bashkimit ose përvetësimit, për të cilat kërkohet miratim paraprak nga ana e BQK-së.
2. Kjo rregullore aplikohet për të gjithë siguresit e licencuar nga BQK-ja që operojnë në Republikën e Kosovës.

### **Neni 2**

#### **Përkufizimet**

1. Të gjitha termet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptim të njëjtë me termet e përcaktuara në nenin 3 të Ligjit nr. 05/L-045 për sigurimet (në vijim: Ligji për sigurimet) dhe/ose me përkufizimet në vijim për qëllimin e kësaj rregulloreje:
  - a) *Bashkimet* - do të thotë bashkim i dy ose më shumë siguresve apo risiguresve, nëpërmjet transferimit të totalit të aktivës dhe pasivës në një sigures të ri;
  - b) *Përvetësimet* – do të thotë procesi i blerjes ose përvetësimit të një pjese ose një kompanie (shoqëri aksionare) të tërë.
  - c) Për qëllime të kësaj rregulloreje, me termin sigures kuptohet siguresi dhe/ose risiguresi.

### **Neni 3**

#### **Bashkimet**

1. Asnjë sigures nuk mund të bashkohet me ndonjë sigures tjetër, pa miratimin paraprak të BQK-së.
2. Siguresi i licencuar për sigurim jetë paraqet në BQK një raport të hartuar nga aktuari i autorizuar, që vërteton se bashkimi ose ndarja nuk është në kundërshtim me interesat e të siguruarve dhe siguresve të përfshirë në këtë proces.

3. BQK-ja do të trajtojë bashkimin si aplikacion për një licencë të re, siç përcaktohet me nenin 10 të Ligjit për sigurimet. Kjo gjithashtu aplikohet nëse qëllimi është të bëhet bashkimi në një sigures të huaj, që rezulton me kryerjen e aktivitetit të sigurimeve në Kosovë si subjekt i varur.
4. Kërkesa për aprovim për siguresin e riorganizuar nëpërmjet bashkimit duhet që ta ketë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - a) vendimin e asambleve të aksionarëve siguresve të përfshirë në operacion për aprovimin e riorganizimit të tyre nëpërmjet bashkimit;
  - b) draft-marrëveshja dhe raporti i detajuar i procesit të bashkimit, të nënshkruar nga përfaqësuesit ligjor të siguresve të përfshira në procesin e bashkimit. Draft-marrëveshja dhe raporti përpihohet me shkrim dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi;
  - c) raporti i ekspertëve të pavarur të licencuar në fusha të ndryshme, për të vlerësuar kushtet e draft-marrëveshjes së bashkimit;
  - d) draft-statuti i siguresit pas realizimit të procesit të bashkimit;
  - e) planet strategjike dhe operative për të kryer bashkimin, ku përfshihen analizat e nevojshme të përvetësimit dhe parashikimet e pasqyrave financiare për siguresin e bashkuar;
  - f) në rast të ndryshimit të drejtorëve dhe menaxherëve të lartë të siguresit të bashkuar, duhet të paraqitet dokumentacioni në përputhje me kërkesat për drejtorët, siç është përcaktuar në Ligjin për sigurimet dhe Rregulloren për drejtorët dhe menaxherët e lartë të sigurimeve;
  - g) struktura e aksionarëve të siguresit të bashkuar.
5. BQK-ja, gjithashtu do të diskutojë me siguresin afatin kohor që do të jetë i nevojshëm për aprovimet paraprake duke lejuar siguresit, që të fillojnë diskutimet me palën tjetër apo palët e tjera të përfshira, pa angazhimin e BQK-së.
6. BQK-ja do të japë aprovimin nëse:
  - a) bashkimi nuk rrezikon gjendjen financiare të siguresit të bashkuar;
  - b) siguresi ka sistem të organizimit, të menaxhimit, të vendimmarrjes dhe të teknologjisë informative, i cili mundëson integrimin komplet të siguresit të bashkuar në mënyrë, që të mos rrezikojë funksionimin e saj;
  - c) bashkimi është ekonomikisht i arsyeshëm.
7. Është përgjegjësi e siguresit që të sigurojë aprovimet nga autoritetet e tjera, që mund të jenë të nevojshme para përfundimit të transaksionit.
8. BQK-ja, para se të vendosë për bashkimin e siguresve, mund të kërkojë mendimin e agjencionit të konkurrencës.

#### **Neni 4** **Përvetësimet**

1. Siguresit e interesuar në përvetësimin e një interesi ose rritjen e interesit ekzistues në ndonjë institucion tjetër financiar brenda apo jashtë Kosovës duhet ta njoftojë BQK-në në fazën fillestare.

2. Varësisht nga natyra dhe niveli (sa i përket përqindjes së kapitalit që siguruesi planifikon të përfshijë) dhe madhësia e transaksionit ndaj madhësisë së siguruesit përvetësues, BQK-ja do të përcaktojë se cilat informata shtesë janë të nevojshme para se të mund të shqyrtohet aprovimi.
3. BQK-ja shqyrton aplikacionin nga aspekti i ndikimit në kapitalin e siguruesit përvetësues, kapacitetin e menaxhmentit të siguruesit përvetësues dhe ndonjë ndryshim të parashikuar në bordin e drejtorëve dhe menaxhmentin e lartë të siguruesit përvetësues.

#### **Neni 5**

#### **Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile**

Shkelja e dispozitave të kësaj rregulloreje, do të jetë subjekt i masave administrative dhe dënimeve me gjobë siç përcaktohet në Ligjin nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore dhe Ligjin 05/L-045 për sigurimet.

#### **Neni 6**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi më 1 mars 2016. Pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohen të gjitha rregullat dhe udhëzimet që kanë të bëjnë me bashkimet dhe përvetësimet e siguruesve dhe çdo dispozitë tjetër që mund të jetë në kundërshtim me këtë rregullore.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

---

Prof. Dr. Bedri Peci